

BANKA E SHQIPËRISË

DEKLARATË PËR SHTYP

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2007

GUSHT 2007

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2007

GUSHT 2007

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për gjashtëmuajin e parë të vitit 2007 rezultoi me një tepricë prej 37.6 milionë eurosh. Flukset hyrëse të kapitalit mundësuan në masën 88.6 për qind financimin e deficitit korent.

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare mund t'i përgjithësojmë në:

- Aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente.
- Thellim i deficitit tregtar dhe i atij korent.
- Rënie e nivelit të huamarrjes së sektorit shtetëror dhe privat, në krahasim me një vit më parë.
- Rritje e detyrimeve të vendit ndaj jorezidentëve, e shprehur kryesisht në formën e depozitave të institucioneve të huaja financiare në sistemin tonë bankar.
- Rritje e rezervave valutore të autoritetit monetar.

I. LLOGARIA KORENTE

Transaksionet korente, të zhvilluara gjatë gjysmës së parë të vitit 2007, vlerësohen në rreth 3.8 miliardë euro ose 16.9 për qind më të larta se në vitin paraardhës. Shkëmbimet tregtare në mallra dhe shërbime kryesojnë vëllimin e transaksioneve korente të Shqipërisë me botën. Mëse 95 për qind e shpenzimeve korente, gjatë kësaj periudhe, kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh ndërkohë që, rreth 35 për qind e të ardhurave korente kanë hyrë në formën e transfertave. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve siguruan përkatësisht 22 për qind dhe 36 për qind të të ardhurave korente.

Deficiti korent, për këtë gjashtëmuaj, u vlerësua 365.8 milionë euro, me një rritje prej rreth 28.5 për qind kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2006.

Deficiti i lartë tregtar ka neutralizuar efektin pozitiv të ngushtimit të deficitit të llogarisë së shërbimeve dhe të rritjes së flukseve pozitive të të ardhurave faktoriale neto, duke mbetur shkaktari kryesor në thellimin e deficitit korent për këtë periudhë.

I. 1. TREGTIA E JASHTME

Shkëmbimet tregtare në mallra në rreth 1.7 miliardë euro, vlerësohen 24 për qind më të larta se ato të së njëjtës periudhë të një viti më parë.

Eksportet (391 milionë euro) edhe gjatë kësaj periudhe kanë vazhduar të rriten me ritme më të shpejta sesa importet (1.4 miliardë euro), respektivisht 26 për qind dhe 23 për qind. Megjithatë, raporti i mbulimit të importeve nga eksportet mbetet përsëri në nivele të ulta (28 për qind), duke dëshmuar për orientim të theksuar të tregtisë së jashtme drejt importeve. Deficiti tregtar vlerësohet rreth 366 milionë euro, me një rritje vjetore prej 28.5 për qind.

Mallrat e ndërmjetëm mbizotërojnë importet tona në rreth 53 për qind të totalit. Ndërkohë, mallrat kapitalë dhe ata të konsumit zënë përkatësisht 13 dhe 31 për qind.

Industria e përpunimit me lëndë të parë të porositësit vazhdon të jetë përcaktuese në marrëdhëniet tona tregtare me botën. Importet e lëndës së parë, të përqendruara kryesisht në tekstile, këpucë dhe metale, përfaqësojnë 14 për qind të totalit të importeve, ndërkohë që 69 për qind e të ardhurave nga eksportet ishin kontribut i rieksporteve.

Situata e përkeqësuar energjitike në vend, ka rezultuar në shpenzime të mëdha për importe të energjisë elektrike dhe gjithashtu, në kërkesë më të lartë për karburante si zëvendësuese të energjisë. Pikërisht “karburante dhe lubrifikante” ka qenë grupmali që ka regjistruar rritjen më të madhe gjatë kësaj periudhe (66 për qind). Në fund të këtij gjashtëmuajori rezultoi të kemi shpenzuar 5 herë më tepër për import energjie elektrike krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e eksporteve vazhdon të ruajë të njëjtat nivele përfaqësimi edhe në fund të këtij gjashtëmuajori. Grupmali “tekstile dhe këpucë” përfaqësoi 50 për qind të totalit eksporteve, duke humbur 5 pikë përfaqësimi nga niveli i të njëjtës periudhë të një viti më parë.

Agresivitetet në tregjet botërore po shfaqin produktet minerale (karburante) dhe metale, grupmallra këta të cilët dyfishuan vëllimet e eksportit krahasuar me gjashtëmuajin e parë të vitit 2006. Afro 50 për qind të karburanteve e përfaqëson nafta e papërpunuar, e destinuar drejt Italisë. Eksportet e metaleve bazë përfaqësohen në pjesën dërrmuese nga giza, çeliku, bakri dhe produkte të ndryshme metalesh.

Struktura gjeografike vazhdon të mbizotërohet ndjeshëm nga vendet e Bashkimit Evropian, megjithatë, ky gjashtëmuajor karakterizohet nga ritme të larta zgjerimi tregtar me partnerët rajonalë.

I. 2. ZHVILLIMET NË ZËRAT E TJERË TË LLOGARISË KORENTE

Transaksionet tregtare në shërbime arritën në 1.3 miliardë euro me një rritje vjetore prej 9 për qind.

Llogaria e shërbimeve u mbyll me një bilanc pozitiv prej 22 milionë eurosh, i ngushtuar me rreth 2 herë kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë. Pasojë

kjo, e rritjes së importeve më shpejt se eksportet, në tregun ndërkombëtar të shërbimeve.

Lëvizjet në llogarinë e shërbimeve ndikohen ndjeshëm nga zhvillimet në "turizëm" (udhëtime), të cilat kontribuojnë në masë të konsiderueshme flukset hyrëse dhe dalëse të kësaj kategorie, përkatësisht me 63 dhe 59 për qind për këtë gjashtëmuor.

Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, të ardhurat nga eksporti në shërbimet e turizmit, gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2007 vlerësohen në 394 milionë euro. Ndonëse shpenzimet ditore janë rritur ndjeshëm (13.4 për qind), rënia e koeficientëve vlerësues të ditëqëndrimit (rreth 7 për qind), ka mbajtur të pandryshueshëm fluksin e të ardhurave. Ndërkohë, numri i jorezidentëve që kanë vizituar Shqipërinë nuk ka pësuar ndryshim të dukshëm.

Importi në këtë sektor (udhëtime) vlerësohet 384 milionë euro, me një rritje vjetore prej rreth 5 për qind. Megjithë rënien prej 26 për qind të kohëqëndrimit të udhëtarëve shqiptarë jashtë vendit, rritja e shpenzimeve turistike ka ardhur si pasojë e rritjes së shpenzimeve ditore (19 për qind) dhe numrit të udhëtarëve (24 për qind).

Shërbimet e tjera u mbyllën me një suficit prej 23 milionë dollarësh kundrejt deficitit prej 26 milionë, të një viti më parë. Ky suficit është mundësuar kryesisht prej rritjes së të ardhurave në pothuaj të gjithë sektorët e shërbimeve, ndërkohë që shpenzimet kanë ruajtur nivelet e një viti më parë.

Ekonomia shqiptare vazhdon të përfitojë të ardhura në valutë prej punës së punonjësve sezonalë dhe investimeve të rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente dhe njëkohësisht, të paguajë interesat për borxhin e jashtëm. Rezultati neto i transaksioneve në të ardhura mbetet pozitiv edhe gjatë këtij gjashtëmuori, dhe vlerësohet në rreth 106 milionë euro, me një rritje vjetore prej 19 për qind. Të ardhurat nga puna, në krahasim me gjashtëmuorin e parë të vitit të kaluar, janë rritur me rreth 9 për qind dhe vlerësohen në 61 milionë euro. Gjithashtu, rritje kanë regjistruar të ardhurat nga interesat prej investimit të rezervës tonë valutore në institucione jorezidente si dhe të ardhurat nga interesat e mbledhur nga investimet e portofolit të institucioneve rezidente jashtë.

Bilanci i transfertave korente, në fund të gjashtëmuorit të parë, u vlerësua në rreth 511 milionë euro. Peshën kryesore (rreth 82 për qind) të të ardhurave në këtë kategori vazhdojnë ta zënë prurjet e emigrantëve shqiptarë me banim jashtë. Gjatë kësaj periudhe këto transfertat kanë arritur nivelin 493 milionë euro, duke qenë 10.7 për qind më të larta se ato të të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Këto transfertat përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të deficitit tregtar, në mëse 51.2 për qind të tij.

II. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Lëvizjet e kapitalit, gjatë gjashtëmuajit të parë të vitit 2007, regjistruan një fluks neto prej rreth 327 milionë eurosh dhe mundësuan, në masën 89 për qind, financimin e deficitit korent. Pas kësaj shifre pozitive, qëndrojnë transfertat kapitale hyrëse prej 44 milionë eurosh si dhe bilanci pozitiv i llogarisë financiare prej rreth 283 milionë eurosh.

Pozicioni i llogarisë financiare në këtë periudhë, përkufizohet në rritje të ndjeshme të detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën (me rreth 281 milionë euro), ndërkohë që pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës qëndrojnë rreth të njëjtit nivel (me një rritje prej 2 milionë eurosh).

Rritja e detyrimeve financiare ndaj botës, këtë gjashtëmuaj, ka ardhur kryesisht prej flukseve hyrëse të kapitalit në formën e investimeve direkte, të huamarrjes me jashtë si dhe të depozitave të institucioneve të huaja financiare në sistemin tonë bankar.

Investimet e huaja direkte vlerësohen në nivelin 145.6 milionë euro ose 16 për qind më të larta, krahasuar me një vit më parë. Këto flukse kapitali janë shndërruar në një faktor mbizotërues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare të vendit.

Faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare ka qenë lëvrimi i kredive afatgjata dhe i atyre të buta nga jashtë, të cilat i kanë shtuar detyrimet nga huamarrja me 62.8 milionë euro. Këto detyrime vlerësohen të jenë 29 për qind më të ulta kundrejt një viti më parë, si rrjedhojë e uljes së huamarrjes nga jashtë si nga sektori shtetëror (17 për qind) ashtu edhe nga ai privat (66 për qind).

Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit dhe të interesit vlerësohen në rreth 27 milionë euro, të barasvlefshme me 7 për qind të eksportit të mallrave.

Ekonomia shqiptare këtë tremujor paraqitet me pothuaj të njëjtin pozicion ndërkombëtar të mjeteve financiare (me një rritje të vogël prej 2 milionë eurosh), por me ndryshime strukturore. Këtë gjashtëmuaj vihet re ndryshim i raportit të mjeteve të investimit. Mjetet në formën e investimeve të portofolit dhe të mjeteve valutore afatshkurtra, janë zhvendosur në investime të rezervave të sistemit bankar në tregun ndërkombëtar, në formën e depozitave. Kështu, rënia e investimeve të portofolit dhe investimeve të mjeteve valutore afatshkurtra respektivisht me 18.4 dhe 15 milionë euro, është balancuar me rritjen prej rreth 35 milionë eurosh të depozitave.

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 38 milionë euro. Rezerva valutore e vlerësuar në 1.4 miliardë euro në fund të periudhës, qëndron në nivele të pranueshme, duke mbuluar rreth 4.1 muaj importe.

Tabelë 1. Bilanci i Pagesave (në milionë euro).

	6M I 2006	6M I 2007
Llogaria korente	-284.7	-365.8
Eksporti i mallrave	310.1	391.3
Importi i mallrave	-1094.7	-1353.2
Bilanci tregtar	-784.6	-961.9
Shërbimet: kredi	559.5	621.2
Shërbimet: debi	-604.2	-642.9
Të ardhurat: kredi	109.2	128.9
Të ardhurat: debi	-19.5	-22.4
Transferta private pa shpërblim	426.0	489.1
Transferta shtetërore pa shpërblim	29.0	22.2
Llogaria kapitale	80.6	43.5
Llogaria financiare	166.2	283.2
Investime direkte	122.3	137.2
Investime portofoli	1.6	18.5
Kapitale të tjera*	39.5	124.8
Gabime dhe harresa neto	83.0	76.8
Bilanci i përgjithshëm	45.1	37.6
Rezervat dhe zëra të lidhur me to		
Mjetet e rezervës	-45.1	-37.6
Ërdorim huash e kredish nga fmn	2.9	2.8
Për t'u mbajtur në vëmendje		
Ndryshimi total në rezerva	16.6	26.7
Nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	-28.5	-10.8

*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.
Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë.

